



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EUROPIAN DHE DIASPORËS

Nr. 14434 Prot

Vlorë, më: 18.09 2024

PROCESVERBAL KONSULTIM PUBLIK

RAJONI 5

Datë 13.09.2024 ora 10:00

Tema: Konsultimi i Programit të Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2025 për Bashkinë Vlorë

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Per të drejtën e informimit” , ligjit nr.146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.13107 datë 21.08.2024.

Marrin pjesë:

Nënkryetari i Bashkisë Vlorë-z. Klevis Kaso, Kryetari i Rajonit 5- Bledar Toja, Drejtori i DFKB-Kozma Mali, anëtar të këshillit bashkiak,, drejtorë të administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, media dhe OJF lokale.

(Në takim morrën pjesë më shumë se 30 persona, listeprezenca bashkangjitur)

Takimin e hapi Nënkryetari i Bashkisë Vlorë, z.Klevis Kaso: Përshendetje, të gjithëve! Ju falenderoj për pjesëmarrjen. Jam së bashku me kryetarin e rajonit 5 z.Bledar Toja dhe drejtorin e financës në bashki z. Kozma Mali.

Jemi mbledhur për të diskutuar mbi buxhetin e planifikuar dhe investimet për rajonin 5. Jemi 3 muaj përpara për ti projektuar dhe buxhetuar kërkesat tuaja. Së bashku kemi edhe drejtorët e administratës për t’ju dëgjuar. Kemi bërë disa investime në rajonin tuaj.

Investimet e parashikuara për rajonin 5:

Rikualifikimi i disa hapsirave të gjelbra në qytetin e Vlorës, lulishte përball Komisarariatit të Policisë. Ka përfunduar projekti.

Rrjeti rrugor pranë Komisarariatit të Policisë Vlorë (segmenti i rrugës Jani Kocani dhe segmenti i rrugës Rakip Malile). Ka përfunduar projekti dhe është në fazë tenderimi.

Rikonstruksioni i Bulevardit të Agrumeve. Ka përfunduar projekti pritet të fillojë zbatimin.

Rikonstruksioni i fasadave të banimit përpara viteve 90. (9 objekte) është në përfundim investimi.

Rikonstruksion i tregut të shumicës. Ka përfunduar projekti dhe zbatimin.

Rikonstruksion i rrugëve në lagjen Kushtrimi. Ka përfunduar projekti dhe është në proces tenderimi.

Sistemimi i disa akseve rrugore, rruga Damian Humariti.

Sistemimi i bllokut pranë fushës së aviacionit. Investim i FSHZH

Park i madh për fëmijë, investim i FSHZH.

Projekti më i mirë është rruga nga policia deri te Mena është projekt që do të ndryshojë të gjithë pamjen.

Qytetar: I keni paratë? Për lulishtet dhe rrugët e brendshme? Se mund të vini prapë e të thoni do të bëjmë. Kanë afat?

Klevis Kaso: janë projekte dhe investime nga FSHZH. Unë jam drejtues politik për rajonin 5. Do ketë përparësi edhe ky rajon. Për çdo sygjërim jemi këtu.

Qytetar: A është menduar për lagjen 11 Janari? Janë 30 familje pa ujë të pijshëm. Nuk keni vënë gjë projekt investim as sot, mos na detyroni të shprehemi. 4 shtylla i duam që sot. Për mobilizim keni ardhur? Kemi problem kanalizimet dhe ujrat e zeza. Ti si nënkryetar ke forcë të madhe, je përgjegjës për drejtorët dhe shërbimet.

Klevis Kaso. Ujësjellësi, rrjeti po rregullohet është në proces. Po kështu do vazhdohet edhe me rrugët.

Qytetar: Problem është gjendja e lagjes. Kanali. Nuk e keni vënë në plan. Mbylleni me beton. Mos e pastroni fare. Për 3-4 vjet fondi i pastrimit aq do vejë kostua. Mbylleni me beton nga të gjitha anët. Nuk duam as rrugë as drita. Duam vetëm kanal in ta mbyllni dhe ujin e pijshëm. Po sëmuremi. Në atë kanal derdhen ujrat e zeza. Do plas kolera. Mos dilni më përpara popullit. Rrogat e deputetit 5 milion dhe pensionet 100 mije. Dhe në kohën e Enverit ishte 4-fish. Po doni votat, punoni. Ose ikni. Kanali është i pari.

Klevis Kaso: Dr i financës ka shënuar prioritetet. Kanali do pastrohet në fillim. Specialistët do

bëjnë një projekt. T'ja cojnë kryetarit dhe këshillit bashkiak.

Qytetar: Lagja kushtrimi pa ndricim, pa gjelbërim, problem ujrat e zeza. Infrastruktura zero. Kemi ardhur në bashki.

Qytetar: Vetëm kërkoni votat. Këtu jeni zgjedhur si kryetar i të gjithëve, jo PS, PD. Kemi problem ujin e pijshëm, ndricimin, gjelbërimin, kanalizimet. Kush e ka fajin për ujin? Pse nuk kemi ujë? Menaxhojeni situatën. Sa do rrimë pa ujë? Ku është dr i ujësjellesit? Kur mbaron projekti? Na jepni zgjidhje, prandaj jeni zgjedhur.

Klevis Kaso: është në proces. Projekti gjerman po vazhdon. Sa të mbaroj dhe do zgjidhet situata. Do kemi ujë 24 orë. Nesër së bashku edhe me drejtorin e ujësjellesit dhe të administratorin e rajonit do takohemi dhe të flasim ku qëndron problem.

Qytetar: Projekt buxheti në fund të vitit si është bërë? Ajdeni shikoni te lagja ime. Projekti të bëhet edhe për në lagjen time. Duhet drita, rrugë, ujë. Jemi në harresë. Mos zbukuroni vetëm Lungomaren.

Klevis Kaso: Do jemi të gjithë atje nesër.

Qytetar: Banor i lagjes Kushtrim. Rruga e qendrës që lidh lagjet, mbushet me ujë kur bie shi. Do priset asfalti. Janë 2 rrugë. Myslym Gjoleka dhe një tjetër. Rruga para karburantit.

Qytetar: Banor i ri te ish Frigoriferi. Bashkia ka 30 vjet që nuk ofron shërbimin urban në ato zona. Janë 300 biznese, 30 mijë banorë dhe 4 km rrugë. S'kemi urban. Jemi grup nga shoqëria civile që po përgatisim shkresën. Te banesat e Entit të banesave, territori është i pasistemuar.

Djegjet në zonën e mbetjeve, të bëhet kapsulim i pjesshëm. Kur do filloj?

Priten pishat, ku është parë kjo gjë?

Sinjalistika rrore dhe vijëzimet në rrugë. Sa kohë duhet që të bëhen?

Gropat në rrugët sekondarë janë problem. Përvec kanaleve që kanë hapur për linjat e ujësjellesit.

Rrugët që po hap ujësjellësi kanë afat për tu kthyer sic ishin? Ka supervisor se po hapen nga 3 herë në vit. Me parate e kujt?

Gjelbërimi, jam agronom dhe e di. Kemi vështirësi me ujitjen. Pse nuk vendosni lule sezonale. Të shikohet çfarë do bëhet me kërkesat.

Stolat e betonit nuk janë me standart. Vendosni edhe stola të tjerë dhe 5 cezma nëpër qytet.

Shezllonet, pse nuk i planifikoni sic duhet për bizneset dhe hotelerite por abuzojnë me nr e shezlloneve. Është zaptim i plazheve. Shikojini.

Kam një propozim. Premtimet po i bëni, sasia e lekëve që keni a është e mjaftueshme? Ka shuimë gjëra që duhen bërë. A keni lekë? Turistët që vijnë në Vlorë psh gjatë sezonit harxhojnë 5 mil plastikë, me paratë e kujt hiqen dhe pastrohen këto mbetje? Të bizneseve që paguajnë taksat?

I njëjti buxhet pastrimi me turist dhe pa turist?

Janë 3 anije nga Bangladeshi. Kanë 3 vjet që flasim. Ato anije marrin 80 mijë dollar në ditë qira. Energjia që prodhojnë është 3-fish i kostos së tregut. Këto 80 mijë dollar në ditë ti jepeshin Vlorës do bliheshin 100 zjarrfikse, ambulance dhe autobusa. Kanë shkatërruar 25 hektar pyll. Ato para të Vlorës janë? T'ja japim Vlorës.

Klevis Kaso: Ke të drejtë por Vlora është e madhe dhe do kohë dhe buxhet të bëhet. Mandate i kryetarit është 4 vjet, jo 1 vit. Prandaj dhe dëgjesat i bëjmë cdo vit t'ju dëgjojmë dhe të planifikojmë. Do takohemi përsëri dhe do i parashikojmë kërkesat.

Qytetar: Probleme ka plot. Por këto që do them me 1 orë punë zgjidhen. Ndricimi, rruga ka 24 shtylla dhe 6 ndricues. 1 llampe në vit. Lulishtja do ndricim. Jepni urdhër dhe të vijnë. Kemi një vit që kemi bërë kërkesë. Lulishten e pastruam dhe sitemuam vetë por nuk janë hequr mbetjet e po shtohen të tjera. Sillni je makine, ti heq.

Qytetar: Lagja Kushtrim, po ta dinin banorët do kishin ardhur të gjithë. Problem janë rrugët me gropa, lluc e ujë. Nxënësit mezi kalojnë për në shkollë. Kemi bërë ankesë edhe te ju, edhe te deputetja Teuta, edhe te Irma koordinatorja..kot që flasim. Pse ju zgjodhëm?

Klevis Kaso: është në proces dhe do bëhet.

Qytetar: Më thuaj kur do bëhet, cfarë date? Do ju ndihmojmë vetë.

Klevis Kaso: Fund tetori fillim nëntori fillon asfaltimi. Edhe për garazhet dhe serviset.

Qytetar: Fjalët tuaja do jua përcjell edhe banorëve të tjerë. Vijnë te infomacioni nuk na shërbejnë. Na mbajnë shënim emrin dhe numrin por nuk na marrin në telefon. Në fund tetori ajdeni filloni. hidhni 5 rrugë zhavorr. Kaq problem është. Tha kryetari vet që do bëhet dhe nuk u bë.

Qytetar; Banor i Lirimit. I kemi kërkuar dhe deputetit ujë dhe ndricim për rrugën, trotuari i ngushtë.

Qytetar: Faleminderit për takimin. Problem kam veshjen e fasadave të pallateve të vjetra si dhe pompat e ujit në cdo hyrje pallati. Bolierët dhe pucetat.

Qytetar: Jam përfaqësues i shoqërisë civile. Pastrimi dhe katet e para të pallateve që janë biznese servisi dhe lavazho. Gjenerojnë shumë mbetje dhe zhurma akustike.

Klevis Kaso; Serviset dhe lavazhot do hiqen.

Qytetar: Kam bërë kërkesë për ndricimin, kosha dhe stola. Është rruga me 50 familje.

Koordinatorë për njoftimin dhe konsultimin publik

Albena Meçi


Albana Naçi